

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-32

M27

Gaqo Mani

PARA
STUHISE

novelë

8JH-32

1727.

GAQO MANI

Paza Stuhisë

- novelë -



2024

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

I

Atilio Danieli, u zgjua fytyrëçelur dhe i gëzuar. Veshi robdeshambrin e kuq, mbathi pantoflat e buta me push prej lëkure lëpuri e, duke fërshëlyer lehtë-lehtë, shkoi drejt e në kuzhinë.

— Sot kam uri, çfarë do të më gatuash për mëngjez, e dashur? — tha me zë të gëzuar dhe melodioz.

— Çfarë të dëshironi, zotni.

Ai thithi buzët, picërroi sytë, bashkoi gishtin tregues me gishtin e madh e përshpëriti si i joshur nga shija e gjellëve:

— Një biftek viçi në skarë, djathë parmixhiano, vezë, gjalpë dhe verë, verë «Rufino».

Fishkëllima e tij u zvarris në korridorin e gjatë të shtruar me udhë të trasha prej leshi ngjyrë bezhë me qenar vishnjë, ndërsa guzhinierja e gëzuar se më në fund po i kthehej oreksi pronarit, tha me vete: «Qenka me humor sot».

* * *

Si hëngri mëngjezin Atilio Danieli, doli në zyrë, thirri administratorin e fabrikës dhe i njoftoi:

— Zoti është me ne, i dashur! Partneri im shqiptar do t'i shesë aksionet. Tani më duket fare pa vend që «Birra Korça» të quhet shoqëri italo-shqiptare, përderisa nuk egziston asnjë santim ka-

pitali shqiptar. Për këtë keni meritë ju, i dashur që me zotësinë tuaj arritët ta nxirrnit fabrikën me humbje katër vjet rresht,

Paolo Vizeti psherëtiu nga kënaqësia dhe tha:
— Po të vepronim ndryshe, nuk do të ishte e mundur t'i frenonim investimet e kapitalistëve shqiptarë, për të cilët artikulli shtatëmbëdhjetë i kontratës qeveritare na detyron të pranojmë jo më pak se dyzet përqind të këtyre investimeve!

— Kjo ka perënduar me shtatë prillin, e sikurse pas çdo perëndimi lind një ditë e re, ashtu duhet të lindë edhe një kontratë e re pa e përfshirë fare jo vetëm artikullin shtatëmbëdhjetë, por edhe të pesëmbëdhjetin e të dhjetin. Kjo është e domosdoshme për të vënë në vend humbjet që na shkaktoi tërheqja taktike.

II

Lefter Andoni e Peço Ligori ngjitën të njëmbëdhjetë shkallët prej betoni e, pasi kaptuan edhe shtatë palë të tjera prej gize të lidhura me njëra-tjetrën, me shule, ndaluan përpara zyrës së inxhinierit. Lefteri trokiti lehtë, çeli portën e hyri me drojtje. Një burrë i trashë me mustaqe të prera shkurt, me një palë sy të vagëlluar, me pamje të heshtur e të vrerosur, pinte birrë qetë-qetë. Barku i rrumbullaktë takonte buzën e tryezës së shkrimit.

Lefteri në fillim u habit sepse s'kishte parë burrë aq të trashë, po shpejt e mblodhi veten duke bërë dy hapa përpara, i zgjati një copë letër. Peço Ligori kishte qëndruar prapa portës.

— Hyrë edhe ti — foli inxhinieri.

Inxhinieri e shpalosi letrën e, pasi u hodhi një sy të porsaardhurve, tha:

— Do të punoni në repartin e varelave me shtatë lekë në ditë. Ju pëlqen?

— Faleminderit, zoti inxhinier, mund të na vini në çfarëdo pune.

— Tani atje, në qoftë se do të punoni mirë...
Ku ke punuar ti?

— Në fabrikën e miellit.

— Po ti?

— Unë punëtor krahu.

Inxhinieri ngriti gotën e birrës, por u duk se u pendua, sepse ata, e veçanërisht Peçoja, ja qepi sytë gotës e u përcuall.

— Keni pirë birrë ndonjëherë?

— Unë vetëm tri herë deri më sot — tha si i zenë në lak Lefteri.

— Unë pi sa herë që kam para — u hodh Peçoja.

— Pse, ke para ti?

— Rrallë, zoti inxhinier.

Inxhinieri qeshi me zë, e aty për aty, sikur të kishte hequr maskën e të zbulonte fytyrën e vërtetë, u çel e u zbut aq shumë sa s'të besohej se ishte ai i pari, i heshtur e i vrerosur. U ngrit nga karrigja duke rënkuar e atëhere ju duk barku i madh e trupit i shkurtër. Inxhinieri u luhat e pas disa çapeve të rënda e të zvarritura, qëndroi përpara gjaçajës, nxori dy shishe birrë e i vuri mbi tryezë.

Sytë e Peços vetëtinë nga një dritë e fuqishme. Një drithmë e lehtë ja tkurri lëkurën. Zgjati dorën e mori shishen; ndërsa Lefteri nuk e preku.

— Pse s'pi ti?

— Falemnderit shumë, zoti inxhinier, s'kam ngrënë asgjë në mëngjez!

Tjetri mbloodhi buzët e mendoj: «Ose do të jetë idiot ky, ose do të shitet». Më në fund inxhinieri mbeti vetë me shishen e paprekur të Lefterit, të cilën e piu mengadalë.

Sjellja e inxhinierit u bëri përshtypje të madhe, e sidomos Lefterit. Po, ky ishte zakoni i tij. Këtë ai e bënte me cilindo që i hynte në zyrë.

Inxhinier Gerhardi, që specialist me përvojë. Në fabrikë kishte venë një metodën e tij shumë racionale në një operacion pune të rëndësishme e këtë metodë s'e gjeje të shkruar në asnjë nga librat teknike të deriatëhershme.

Ëndërra e dikurshme për të bërë para kishte përënduar që me kohë dhe inxhinier Gerhardi kishte mbetur po aq i varfër e po aq i pakënaqur siç ishte përpara tridhjetë vjetësh.

Kolegët e tij kishin shkuar përpara në jetë. Ai habitej si ata kishin mundur të bëheshin të pasur. Disa qenë bërë pronarë e koncesionerë, disa të tjerë përfaqësues të firmave të mëdha, ca oficerë madhorë e deri zyrtarë të kancelarisë së Rajhut. Ja, Atilio Danieli. Ç'kishte qenë ai? Një fashist aktiv që kishte marshuar mbi Romë në tetor të vitit 1922. Ndërsa sot Danieli ishte jo vetëm pronar i fabrikës, por edhe përfaqësues i firmës «Hellmann». Pse, nuk mund ta përfaqësonte inxhinier Gerhardi firmën «Hellmann», ose të paktën firmën «Topi» që kishte ngjashmëri me të parën? Jo. Ai kishte mbetur në vend. Vetëm atij s'i kishte qeshur fati.

Kishte dhe raste ku i dukej së edhe ashtu s'qe keq, por ajo kënaqësi qe falso. Ai desh të bëhej i pasur, kërkonte me çdo kusht të arrinte diçka, që ta

shquante nga një nëpunës i zakonshëm. Ai gjithmonë i kishte urryer nëpunësit. Tek mendonte servilizmin e tyre, ndjente një farë pështirosjeje. Ai e urrente administratorin ose drejtorin e fabrikës, Paolo Vizetin. Ai vërtet ishte administrator i fabrikës, por çdo gjë e merrte të gatshme nga inxhinieri e pastaj bënte vetëm një regjistrim, jepte një urdhër dhe hidhte një firmë.

Paolo Vizetit i kanë rezervuar një apartament komod brenda në fabrikë, ndërsa inxhinier Gerhardi banon në një shtëpi karakatinë pesëmbëdhjetë minuta larg fabrikës e pi ujë pusi. Vizetin e kanë vënë në një zyrë luksoze, larg zhurmës së maqinave e tymit të furrave, i kanë lënë në dispozicion një veturë «Lançia», i kanë lidhur një rrogë me tetëqind franga në muaj përveç tri përqind mbi fitimet totale, ndërsa Gerhardi merr tetëdhjetë franga më pak në muaj e dy përqind mbi fitimet totale. Ja pra ç'do të thotë të kesh të drejtën e firmës!

Ata të dy kanë ardhur për të njëjtin qëllim në Shqipëri; të fitojnë para! Por, ndërsa Vizeti di të llogaritë edhe santimin, Gerhardi jo. I pari mburret me kursimet e veta, kurse i dyti shpeshherë mbetet pa cigare!

III

Kur u kthye në shtëpi, Lefteri qe fare i kapitur. Dymbëdhjetë orë i kërrusur mbi varetat, me dy çekanë, njëri prej të cilëve quhej vare e peshonte pesë kile, kishte rrahur rrathë, i kishte shtrënguar e

puthitur që, kur të mbushej varela me ujë e të vijej në provë me ajër të komprimuar, të mos kishte asnjë humbje ose rrjedhje, ndryshe përgjegjësi i repartit ta kthente vozën dhe atëhere duhej të bënte punë të dytë pa shpërblim.

Në përgjithësi kjo punë s'donte aq mjeshtëri se sa forcë krahu.

Rrinte shtrirë në shtrat me duart prapa kokës e sytë i mbante te dritarja e vogël, nga e cila vinte një dritë e përhime.

U kthye më krah, por drita në dritare sikur po bëhej më e fortë dhe ndoshta ai ngacmim si edhe tingujt e çekanëve që i kumbonin ende në vesh, ja turbullonin kokën. S'qe mësuar me zhurma të tilla, as me një ngarkesë pune të tillë që të drobitte. Ndoshta për këtë arsye punëtorët në këtë fabrikë i dukeshin si shumë të rraskapitur e gojëkyçur. Por përshtypje më të madhe i kishin lënë inxhinieri edhe përgjegjësi i repartit, i cili disa herë e kontrollonte punën.

Nga Tasi Çuka kishte dëgjuar se Inxhinier Gerhardi qe një tip i mbyllur, pa shokë e miq e për më tepër s'përzihej në politikë. E kundërta e tij qe përgjegjësi i repartit, Nino Maconi. Disa punëtorë thoshin: «Ai jo vetëm që është sahanlëpirës, po edhe spiun i Atilio Danielit» edhe Tasi e kishte quajtur njeri të poshtër.

Jeta në fabrikë sa shkante dhe e tërhiqte. Tek ajo gjente diçka të re që s'e kishte gjetur në punën e parë. Ja, përsëri i dalin para syve punëtorët.

Me Peço Ligorin u bë shok që ditët e para, por këto ditë është njohur dhe me Gurin e Vaskës, punëtorë të vjetër që dinë e njohin shumë gjëra në fabrikë, njohin edhe njerëzit, ua dinë edhe huqet

e hallet. Tek këta Lefteri vëren frikën e pushimit nga puna që i shtyp çdo çast e që ua venit jo vetëm rininë, por edhe forcën shpirtërore. Se mos vetëm te këta e gjen këtë ndjenjë. Ju kujtuan fjalët e Gurit:

— Kjo fabrikë, o vëlla, e ka punën me diell. Sa djeg dielli, ka punë sa të të bjerë bretku, ama, po zuri të ftohtët e të të nisë thëllim, del Ninoja me listë e thërret emrat. Ti pret me zemër të ngrirë, dëgjon emrin e shokut, pastaj të vjen radha edhe ty. Var mësallën në gozhdë, vete në zyrë e lan hesapet. Pret pastaj vitin tjetër. Del shkurti, po nganjëherë edhe marsi bën ftohtë, po ti vjen e zë portën e madhe. Pret. Të thonë javën tjetër, do s'do, ngre kokën nga qielli e thua: «Epo në prill do të hapet moti», lëri pastaj rregullat e tjera, nejse do t'i marrësh vesh një e nga një. Po hap sytë nga ai Ninoja, se ai s'ka shpirt njeriu!

— Vetëm të dish një gjë, o Lefter, — kishte shtuar Vaska— po të panë që ke fuqi e je kokulur, lëkurën të nxjerrin, pa të bëjnë ndonjë të mirë sa për sy e faqe, ama ti s'e merr vesh fare se në anën tjetër ta nxjerrin më dysh.

Lefteri, kishte vënë buzën në gaz.

Që atëhere Lefteri qe bërë shok edhe me këta të dy dhe drekave hante bukë bashkë me ta, bënte shaka dhe i gërmonte si dheun preshajka, sipër e sipër, po nganjëherë ua prekte dhemkat dhe atëhere dukej fare sheshit se si kërcenin ata e se si e nxitnin që t'u tregonte ngjarje. Lefteri po ua zbulonte shpirtin dalëngadalë.

Dalëngadalë dhe Lefteri po mësohej me punën e rëndë. Për katër muaj ai e përvetësoi zanatin sikur të kishte një vit që punonte. Ndoshta për këtë arsye përgjegjësi i repartit kishte filluar të afro-

hej me të. Bisedonte me të, e qeraste me birrë dhe ua tregonte punëtorëve të tjerë si punëtorin shembull. Shpeshherë i shënonte në ditar edhe ndonjë orë të tepërt. Në përgjithësi Ninoja hiqej si mik i Lefterit. Në të vërtetë Ninoja qe i ashpër, i rreptë e fjalëpakë me cilindo. Sjelljen e tij ndaj Lefterit e kishin vënë re edhe punëtorët e tjerë të repartit të mbushjes, kështu që dhe filluan ta ngisnin.

— A e shihni bre se si ja hodhi trutë e gomarit.

Lefteri kishte qeshur. Në të vërtetë prej kohësh ishte në pritje që të shihte se ku do të dilte Ninoja. Një të premte, kur kishte marrë rrogën (mbasi në fabrikë paguanin çdo të premte), Ninoja e pyeti Lefterin:

— Je i kënaqur me mëditjen?

Lefteri qeshi dhe hapi pëllëmbën:

— Ja, mjaftojnë këto për një javë?

— Punëtorët e tjerë marrin më pak.

— Nuk flas vetëm për vete.

— Ti shiko punën tënde, se edhe për ty s'pyet kush.

Pas një heshtjeje të shkurtër, Lefteri shtoi:

— E dini se punëtori mezi jeton? Ju, bie fjala, keni ardhur këtu për të fituar dhe ç'është e vërteta po fitoni mirë, sepse merrni dhjetë herë më shumë se unë. Megjithatë ma thotë mendja se përsëri nuk jeni i kënaqur!

— Ti mos bëj krahasime të tilla, sepse gabon! Pagesa shkon sipas punës, s'mund të marrin të gjithë njëlloj.

— Nuk thashë ashtu, por, duke pasur parasysh se njerëzit e kanë gojën njësoj si edhe vdekjen...

— Këtu ke të drejtë, por mos harro se njeriu